

## NJOFTIM PUNËSIMI

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK</b></p>         | <p>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë. Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj <b>për një vend pune: Punëtor pranë Logjistikës në Njësinë Operative Shijak</b> nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për sigurimin e materialeve te nevojshme qe të jenë në dispozicion për riparime dhe investime. Detyrat përfshijnë gjithashtu monitorimin për gjendjen e stokut dhe propozon furnizime të reja kur është e nevojshme.</p> |
| <p><b>Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:</b></p>         | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemon dhe vendos në vendet e përcaktuara mallrat e blera që bëhen hyrje në magazinën e NjO-së bazuar në Fletë Hyrjen e magazinës.</li> <li>• Përgatit për dalje nga magazina e NjO-së dhe zhvendos/lëviz nga vendi mallrat që dalin nga magazina sipas Fletë Daljes së magazinës.</li> <li>• Zhvendos/lëviz dhe sistemon mallrat në magazinën e NjO-së në periudhën e kryerjes së inventarit fizik vjetor.</li> <li>• Mban evidenca për hyrje-daljet e materialeve dhe kryen inventarizime periodike.</li> <li>• Organizon transportin dhe shpërndarjen e materialeve në terren.</li> <li>• Zbaton rregullat e sigurisë dhe procedurat e punës në magazinë dhe gjatë transportit.</li> </ul>  |
| <p><b>Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:</b></p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Eksperienca pune të mëparshme.</li> <li>• Librezë e Punës</li> <li>• Çertifikatë Familjare</li> <li>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës</li> <li>• Dy fotografi</li> <li>• Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar</li> <li>• Dëshmi Penaliteti</li> <li>• Raporti Mjekësor</li> <li>• Vërtetim Vendbanimi</li> </ul>   |

|  |   |
|--|---|
| <b>Kushtet e punës:</b>  | <ul style="list-style-type: none"><li>• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.</li><li>• Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.</li></ul> |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 25.06.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.</li></ul> |   |